

VENDIM
Nr. 311, datë 21.11.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR VLERËSIMIN ETIK DHE
PROFESIONAL TË PROKURORËVE TË KOMANDUAR NË KËSHILLIN E LARTË
TË PROKURORISË**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, nenet 159, 189, 190, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe me propozimin e grupit të punës ngritur me urdhrin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 129, datë 14.9.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores ‘Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë’”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot, më 21.11.2022.

KRYETAR
Alfred Balla

RREGULLORE
PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË PROKURORËVE TË KOMANDUAR

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si elementi bazë i zhvillimit të karrierës dhe përmirësimit të vazhdueshëm të etikës dhe aftësive profesionale të prokurorëve.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave që plotësojnë skemën e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3
Parimet e vlerësimit

Vlerësimi i prokurorit të komanduar bazohet në parimin e meritokracisë, promovimit dhe të zhvillimit të karrierës. Procesi i vlerësimit mbështetet në parimet e efikasitetit, të procesit të rregullt ligjor, si dhe të parimit të konfidencialitetit.

Neni 4 Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për vlerësimin e prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për kohën që ata kanë ushtruar detyrën pranë Këshillit.

2. Këto rregulla nuk zbatohen për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit, i cili është komanduar në struktura të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe ruan statusin e magistratit.

Neni 5 Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) *“Dosja e vlerësimit”* është dosja e hapur për secilin prokuror të komanduar që përmban burimet e vlerësimit sipas kësaj rregulloreje dhe çdo akt të marrë gjatë procedurës së vlerësimit;

b) *“Dosja personale e prokurorit të komanduar në Këshill”* është dosja e prokurorit sipas nenit 38 të ligjit për statusin.

c) *“Këshill”* është Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

ç) *“Komisioni”* është Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill;

d) *“Prokurori i komanduar”* është prokurori i komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

dh) *“Ligji për statusin”* është ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;

e) *“Mendimi i raportuesit”* është raporti vjetor periodik mbi punën e prokurorit të komanduar, i hartuar nga raportuesi, sipas formularit standard të miratuar nga Këshilli, bashkëlidhur kësaj rregulloreje (aneksi 3).

ë) *“Mendimi i kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”* është akti i hartuar nga kryetari i Këshillit, cili përmban mendimin e tij mbi aftësitë e prokurorit të komanduar në lidhje me kriterin *“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”* dhe *“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”*, sipas formularit standard të miratuar nga Këshilli, bashkëlidhur kësaj rregulloreje (aneksi 4).

f) *“Projektraporti i vlerësimit të prokurorit të komanduar”* është akti i hartuar nga relatori, sipas formularit standard të miratuar nga Këshilli, bashkëlidhur kësaj rregulloreje (aneksi 6), që përmban, për secilin prokuror të komanduar, të dhënat dhe informacionet sipas nenit 93 të ligjit për statusin, analizën e tyre dhe propozimin për nivelin e vlerësimit.

g) *“Raportues”* konsiderohet organi kolegjal apo individual i Këshillit, pranë të cilit prokurori i komanduar caktohet, sipas rolit dhe funksionit, dhe me të cilin bashkëpunon më afër. Sipas kësaj rregulloreje, gjatë periudhës së komandimit të prokurorit, mund të ketë më shumë se një raportues.

gj) *“Relacioni periodik i prokurorit”* është dokumenti i përpiluar nga prokurori i komanduar. Relacioni përmban të dhëna faktike mbi detyrat dhe punën e prokurorit të komanduar, sipas formularit standard të miratuar nga Këshilli, bashkëlidhur kësaj rregulloreje (aneksi 2).

h) *“Relatori”* është anëtari i Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill dhe/ose anëtari zëvendësues, i caktuar me short për çdo vlerësim.

i) “*Vetëvlerësimi i prokurorit të komanduar*” është vlerësimi i kryer nga prokurori i komanduar mbi aftësitë e tij etike dhe profesionale gjatë periudhës së vlerësimit, sipas formularit standard të miratuar nga Këshilli, bashkëlidhur kësaj rregulloreje (aneksi 5).

i) “*Vlerësim i përshpejtuar me kërkesë*” është vlerësimi që kryhet në zbatim të nenit 97 të ligjit për statusin.

j) “*Vlerësim i përshpejtuar i detyruar*” është vlerësimi që kryen Këshilli në periudhën kalimtare, sipas nenit 25 të ligjit nr. 48/2019 “*për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 96/2016*”.

Neni 6

Periudha e vlerësimit

1. Për çdo prokuror përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale, sipas parashikimeve të nenit 84, pikat 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin.

2. Periudha e lejes së papaguar nuk llogaritet si përvojë profesionale për efekt të përcaktimit të periudhës së vlerësimit .

3. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike.

4. Kur gjatë periudhës së vlerësimit, prokurori e ka ushtruar funksionin (pjesërisht) i caktuar në një pozicion në prokurori dhe (pjesërisht) i komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, vlerësimi i tij etiko-profesional kryhet veçmas për secilin pozicion. Vlerësimi përfundimtar për periudhën e vlerësimit kryet sipas skemës së përcaktuar në pikat 12-14 të Metodologjisë. (Aneksi 1).

Neni 7

Kriteret e vlerësimit

1. Vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

a) aftësitë profesionale të prokurorit;

b) aftësitë organizative;

c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të prokurorit;

d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

2. Vlerësimi etik dhe profesional i prokurorit kryhet sipas kriterëve të vlerësimit, të matura nga treguesit përbërës për secilin kriter, sipas metodologjisë së pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit.

3. Standardet e nevojshme për matjen e treguesve përcaktohen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

4. Vlerësimi etik dhe profesional ndjek me rigorozitet rregullin e formalizmit, duke dokumentuar me shkrim çdo veprim që kryhet, i cili më pas përfshihet në dosjen e vlerësimit.

Neni 8

Burimet e vlerësimit

Vlerësimi i prokurorit të komanduar bazohet në këto burime:

a) dosja personale e prokurorit;

b) vetëvlerësimi i kryer nga prokurori;

c) relacioni periodik i prokurorit të komanduar

ç) mendimi vjetor periodik i raportuesit;

d) mendimi i kryetarit të Këshillit;

dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj prokurorit gjatë periudhës së vlerësimit;

- e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e prokurorit në veprimtaritë trajnuese;
- ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj prokurorit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
- f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;
- g) kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
- gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të prokurorit.

Neni 9

Përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar

Kur Këshilli vendos mbarimin e statusit të një prokurori, për veprimtarinë e të cilit ka filluar vlerësimi etik dhe profesional, deklarohet përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar.

Neni 10

Prokurori që vlerësohet

1. Personeli administrativ i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në cilësinë e specialistit të burimeve njerëzore që merret me administrimin e dosjeve personale, brenda dy javëve të para të muajit janar, vë në dispozicion të prokurorit të komanduar, të dhënat që ndodhen në dosjen e tij personale, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me detyrat e kryera në Këshill nga prokurori i komanduar, për periudhën e punës deri në fund të vitit paraardhës kalendarik.

2. Prokurori i komanduar në Këshill, brenda muajit janar të çdo viti, plotëson në dy kopje “*Relacionin periodik të prokurorit*”, për periudhën e punës deri në fund të vitit paraardhës kalendarik. Relacioni periodik protokollohet në sekretari dhe bëhet pjesë e dosjes personale të prokurorit.

3. Raportuesi, brenda muajit shkurt të çdo viti, plotëson dokumentin e mendimit vjetor periodik për prokurorin e komanduar dhe e protokollon në sekretari, duke i përcjellë një kopje edhe prokurorit të komanduar.

4. Brenda tri ditëve nga njoftimi i plotësimit të formularëve, sipas pikës 3 të këtij neni, prokurori mund të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar, duke paraqitur kërkesë për zhvillimin e një takimi me Raportuesin.

5. Pas realizimit të dëgjësës me prokurorin, Raportuesi jep mendimin përfundimtar në lidhje me veprimtarinë e prokurorit, duke plotësuar rubrikën e këtij formulari të emërtuar “*Mendimi përfundimtar*”.

6. Prokurori, i cili është përcaktuar në listën e miratuar nga Këshilli për vlerësimin etik dhe profesional, kryen vetëvlerësimin e tij, sipas formularit standard të miratuar nga Këshilli, për periudhën që ka qenë i komanduar në Këshill (aneksi 5). Formulari i “*Vetëvlerësimit të prokurorit të komanduar*” i dërgohet kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nëpërmjet zyrë së protokollit, brenda 3 javëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të Këshillit, për fillimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional.

7. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë jep mendimin e tij, duke plotësuar formularin e “*Mendimit të kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë*” dhe ia njofton atë prokurorit, jo më vonë se katër javë nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional.

8. Brenda tri ditëve nga njoftimi i mendimit paraparak, prokurori mund të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me kryetarin e Këshillit.

9. Pas realizimit të dëgjësës me prokurorin, kryetari jep mendimin përfundimtar në lidhje me veprimtarinë e prokurorit, duke plotësuar rubrikën e këtij formulari të emërtuar “*Mendimi përfundimtar*”.

Neni 11

Roli i relatorit

1. Relatori është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit të komanduar, dhe merr masat e mëposhtme për:

- a) njoftimin e prokurorit për fillimin e procedurës së vlerësimit;
- b) njoftimin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për fillimin e procedurës së vlerësimit;
- c) mbledhjen e dokumentacionit të vlerësimit, duke bashkëpunuar dhe komunikuar me prokurorin, komisionin përkatës dhe çdo institucion tjetër;
- d) krijimin e dosjes së vlerësimit;
- e) njoftimin e kryetarit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill, për krijimin e dosjes së vlerësimit;
- f) hartimin e projektraportit të vlerësimit të prokurorit.

2. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij relatori ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

Neni 12

Roli i Komisionit

Komisioni është përgjegjës, për:

1. Përgatitjen dhe propozimin drejtuar Këshillit, brenda muajit nëntor, të programit vjetor të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve për vitin pasardhës;
2. Kujdeset dhe ndjek procedurën e vlerësimit për çdo prokuror, të përcaktuar në listën e vlerësimit;
3. Pas krijimit të dosjes së vlerësimit dhe përgatitjes së raportit analitik, Komisioni vlerëson, nëse dokumentacioni i dosjes së vlerësimit është i plotë e mund të vijohet me hartimin e projektraportit të vlerësimit, ose i kërkon relatorit marrjen e të dhënave të tjera nga burimet e vlerësimit, duke i përcaktuar ato.

Neni 13

Roli i Këshillit

Këshilli është përgjegjës për:

1. Miratimin brenda muajit nëntor të çdo viti, të programit vjetor të vlerësimit që do të realizohet në vitin pasardhës, me listën e prokurorëve, për të cilët përfundon ose ka përfunduar periudha e vlerësimit në vitin përkatës, si dhe periudhën e vlerësimit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Këshillit;
2. Miratimin, me ose pa ndryshime, të raportit përfundimtar të vlerësimit ose të kërkojë hartimin e një raporti të ri të vlerësimit nga relatori, pas shqyrtimit të projektraportit të vlerësimit dhe seancës dëgjimore, nëse ajo zhvillohet;
3. Këshilli publikon në faqen zyrtare në internet, ekstrakte të raportit të vlerësimit dhe të vendimit, sipas formës standarde të miratuar prej tij.

KREU II

PROCEDURA E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL

Neni 14

Fazat e vlerësimit

Vlerësimi etik dhe profesional zhvillohet sipas fazave të mëposhtme:

- a) veprimet paraprake, të cilat përfshijnë përgatitjen e programit të veçantë të vlerësimeve të prokurorëve të komanduar dhe caktimin e relatorit për çdo vlerësim;
- b) mbledhja e dokumentacionit dhe krijimi i dosjes së vlerësimit nga relatori;
- c) shqyrtimi i plotësimit të procedurave të vlerësimit nga Komisioni;
- ç) hartimi i projektraportit të vlerësimit nga relatori përkatës;
- d) miratimi i projektraportit të vlerësimit nga Komisioni.
- dh) miratimi i raportit të vlerësimit nga Këshilli.

Neni 15

Programi i vlerësimit

1. Në programin e vlerësimeve etike dhe profesionale periodike të miratuar nga Këshilli, me propozim të Komisionit, brenda muajit nëntor të çdo viti, përfshihet edhe vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve të komanduar në Këshill.

2. Në përgatitjen e projektprogramit, Komisioni mbështetet nga njësi e burimeve njerëzore. Kjo njësi, brenda muajit shtator, i paraqet Komisionit listën emërore të prokurorëve të komanduar, të përditësuar me të dhënat e mëposhtme:

- a) periudha efektive e komandimit në Këshill, të secilit prokuror;
- b) pozicioni/roli/funksioni i prokurorit;
- c) periudha për të cilën prokurorit i është bërë vlerësimi i fundit;
- d) çdo e dhënë tjetër që Komisioni e vlerëson të nevojshme për qëllim të hartimit të programit.

3. Projektprogrami hartohet, bazuar në parimin e kryerjes së vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve në kohën e duhur.

4. Vendimi që miraton programin publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Neni 16

Caktimi i relatorit

1. Para fillimit të çdo tremujori, Këshilli, me propozim të Komisionit, përcakton listën e prokurorëve të komanduar në Këshill, që i nënshtrohen vlerësimit sipas programit të miratuar.

2. Bazuar në listën e mësipërme, mbledhja plenare e Këshillit cakton me short relatorin për çdo vlerësim, duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës. Për shkak të ngarkesës së punës dhe kur Komisioni e çmon të nevojshme, në shortin për zgjedhjen e relatorit përfshihen edhe anëtarët zëvendësues. Për prokurorët e komanduar, për të cilët raportues konsiderohet Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill, relatori përkatës do të zgjidhet nga anëtarët zëvendësues.

3. Relatori i njofton prokurorit fillimin e procedurës së vlerësimit, sipas nenit 85, pika 2 të Ligjit për Statusin, dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tij.

4. Në rast se prokurori paraqet kërkesë për përjashtimin e relatorit për vlerësimin, Këshilli vendos jo më vonë se tri ditë nga depozitimi i saj. Nëse relatori i çështjes përjashtohet, Këshilli zhvillon menjëherë procedurat e shortit për caktimin e një relatori të ri.

Neni 17

Dosja e vlerësimit

1. Relatori, brenda dy javëve nga paraqitja e aktit të vetëvlerësimit të prokurorit, merr masat për krijimin e dosjes së vlerësimit. Prokurori ka të drejtë, në çdo kohë, të marrë kopje apo ekstrakte të akteve të përditësuara.

2. Në dosjen e vlerësimit, veç akteve dhe informacioneve të parashikuara në nenin 90, të ligjit për Statusin dhe informacioneve nga Shkolla e Magjistraturës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave, përfshihen dhe informacione nga institucione të tjera audituese ose kontrolluese, të cilat kërkohen kur çmohet e nevojshme.

3. Relatori mbledh gjithashtu:

a) relacionet periodike të hartuara nga prokurori i komanduar, sipas formatit të miratuar nga Këshilli, të depozituara në zyrën e Protokollit;

b) mendimet vjetore periodike të raportuesit të hartuara sipas formatit të miratuar nga Këshilli, të depozituara në zyrën e Protokollit.

c) Mendimin e kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të hartuar sipas formatit të miratuar nga Këshilli, të depozituar në zyrën e Protokollit.

Neni 18

Hartimi i projektraportit të vlerësimit

1. Brenda një muaji nga krijimi i dosjes së vlerësimit dhe pasi Komisioni i ka vlerësuar të plota procedurat, relatori harton projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional, sipas formës standarde të miratuar nga Këshilli.

2. Projektraporti i hartuar nga relatori diskutohet dhe miratohet në Komision.

3. Projektraporti i miratuar nga Komisioni i njoftohet prokurorit, i cili informohet për të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit dhe për ta kundërshtuar atë me shkrim brenda 2 javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas nenit 94 të Ligjit për Statusin.

4. Prokurori ka të drejtë të dëgjohet nga Këshilli në mbledhjen plenare, në të cilën do të shqyrtohet projektraporti i vlerësimit.

5. Projektraporti i vlerësimit është pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit.

Neni 19

Projektraporti i vlerësimit dhe vendimi i Këshillit

1. Projektraporti i vlerësimit i përcillet për shqyrtim mbledhjes plenare të Këshillit, nga relatori. Si rregull, çështja përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit.

2. Çdo anëtar i Këshillit ka akses në dosjen e vlerësimit. Në rast se ndonjë nga anëtarët e Këshillit ka mendim ndryshe nga relatori, paraqet mendimin e tij të arsyetuar, duke bërë edhe propozimet konkrete, para vendimmarrjes së Këshillit.

3. Këshilli zhvillon seancën dëgjimore në prani të prokurorit subjekt vlerësimi, si dhe personave të tjerë, nëse kjo kërkohet nga prokurori ose nëse kjo është e nevojshme për të sqaruar faktet.

4. Nëse prokurori nuk ka kërkuar të dëgjohet nga Këshilli, çështja shqyrtohet bazuar në relatimin e çështjes nga relatori, i cili u përgjigjet edhe pyetjeve eventuale nga anëtarët e Këshillit.

5. Nëse prokurori subjekt vlerësimi ka kërkuar të dëgjohet, çështja shqyrtohet bazuar në relatimin e çështjes nga relatori dhe në shpjegimet e prokurorit, i cili, gjatë dëgjësës, nuk duhet të përsërisë përmbajtjen e paraqitur në kundërshtimin me shkrim.

6. Çdo anëtar i Këshillit mund të bëjë pyetje për relatorin dhe prokurorin, subjekt vlerësimi.

7. Këshilli urdhëron shtyrjen e seancës për jo më shumë se 30 ditë, nëse gjatë shqyrtimit të projektraportit të vlerësimit konstatohen gabime procedurale ose materiale, ose nëse nevojiten prova të tjera që mund të ndikojnë në nivelin e vlerësimit; dhe korrigjimi i këtyre gabimeve nuk mund të bëhet menjëherë, për shkak të nevojës për të marrë dokumente të tjera.

8. Këshilli, pasi shqyrton projektraportin e vlerësimit dhe duke u bazuar në përfundimet e seancës dëgjimore, pasi dëgjon mendimet ndryshe të anëtarëve të Këshillit, nëse ka, vendos të miratojë, të miratojë me ndryshime ose të kërkojë hartimin e një projektraportit të ri të vlerësimit, nga anëtari relator.

9. Në rastet, kur Këshilli e vlerëson prokurorin me një nivel të ndryshëm ose bën një arsyetim të ndryshëm nga ai i propozuar në projektraportin e vlerësimit, në vendim pasqyrohen arsyet përkatëse. Raporti i vlerësimit që miratohet nga Këshilli është pjesë përbërëse e vendimit.

10. Në rastin, kur prokurori vlerësohet “i pamjaftueshëm”, prokurorit i ulet paga me dy për qind, gjatë dy viteve kalendarike pas këtij vlerësimi.

11. Kur prokurori vlerësohet “i pamjaftueshëm”, Këshilli i dërgon raportin e vlerësimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

12. Projektraporti i vlerësimit, çdo vendim i Këshillit dhe, sipas rastit, vendimet e mundshme gjyqësore, duhet të përfshihen si pjesë e dosjeve individuale të prokurorit.

KREU III VLERËSIMI I PËRSHPEJTUAR

Neni 20

Rastet e vlerësimit të përshpejtuar

1. Vlerësimi i përshpejtuar bëhet vetëm me kërkesë me shkrim të prokurorit, kur ai kërkon:

- a) të transferohet;
- b) të ngrihet në detyrë.

2. Këshilli vendos fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar për periudhën që përfshin vitin e fundit kalendarik, vetëm nëse veprimtaria profesionale dhe etike e prokurorit nuk është vlerësuar për dy vitet e fundit kalendarike.

3. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe, vlerësimi i përshpejtuar realizohet, për aq sa është e mundur, sipas rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të caktuara nga Ligji për Statusin dhe nga kjo rregullore.

Neni 21

Rregulla të veçanta

1. Këshilli miraton program të veçantë për prokurorët që vlerësohen me procedurë të përshpejtuar. Bashkë me miratimin e programit, Këshilli zgjedh edhe relatorin. Brenda 5 ditëve nga miratimi i programit, relatori kryen njoftimet në institucionet përkatëse për marrjen e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e prokurorit.

2. Brenda tri javëve nga marrja e njoftimit të relatorit, prokurori përgatit aktin e vetëvlerësimit sipas formatit standard.

3. Relatori, i mbështetur nga struktura administrative e Këshillit, merr masa për mbledhjen e akteve, krijimin e dosjes së vlerësimit, si dhe për hartimin e projektraportit të vlerësimit, në një kohë sa më të shpejtë dhe në çdo rast, jo më vonë se një muaj nga paraqitja e aktit të vetëvlerësimit të prokurorit.

4. Projektraporti i vlerësimit i njoftohet prokurorit të komanduar dhe përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit.

5. Viti kalendarik, për të cilin prokurori është vlerësuar në mënyrë të përsheptuar, përjashtohet nga periudha e vlerësimit periodik.

KREU IV PËRFUNDIMI I VLERËSIMIT

Neni 22 **E drejta e ankimit**

1. Kundër vendimit të Këshillit, prokurori ka të drejtën e ankimit vetëm për shkelje të rënda procedurale.

2. Ankimi paraqitet në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar të Këshillit.

Neni 23 **Arkivimi i dosjes së vlerësimit**

1. Kur vlerësimi i prokurorit bëhet përfundimtar, rezultati i vlerësimit përfshihet në dosjen personale të prokurorit.

2. Dosja e vlerësimit arkivohet sipas rregullave të përgjithshme për arkivimin e akteve të Këshillit.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 24 **Rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional gjatë periudhës kalimtare**

1. Gjatë periudhës kalimtare, sipas nenit 25, të ligjit nr. 48/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, sa herë që kërkohet ngritja në detyrë ose lëvizja paralele, Këshilli bën vlerësim të përsheptuar të detyruar të prokurorit.

2. Për këtë vlerësim zbatohen rregullat e përcaktuara për vlerësimin e përsheptuar me kërkesë, të parashikuara në nenin 21 të kësaj rregulloreje.

Neni 25 **Rregulla të posaçme për vlerësimin e parë etik dhe profesional sipas kësaj rregulloreje**

1. Për vlerësimin e parë etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshill sipas kësaj rregulloreje, relacioni i prokurorit dhe mendimi i raportuesit do të plotësohen, për të gjithë periudhën e mëparshme të komandimit, në bazë vjetore.

2. Relacioni i prokurorit depozitohet në zyrën e Protokollit, brenda një muaji nga miratimi i kësaj rregulloreje nga Këshilli. Mendimi i raportuesit depozitohet në zyrën e Protokollit, brenda dy muajve nga miratimi i kësaj rregulloreje nga Këshilli. Në vijim, këto burime do të hartohen me frekuencë periodike vjetore, sipas rregullave të nenit 10 të kësaj rregulloreje.

3. Në rastin e prokurorit të komanduar në Këshill, periudha e mëparshme vlerësimit, sipas pikës 1 të këtij neni, do të llogaritet duke filluar nga viti 2019. Prokurori i komanduar harton një relacion periodik, në bazë vjetore, për periudhën e komandimit, sipas formatit standard të miratuar nga Këshilli. Raportues për këtë periudhë konsiderohet Komisioni i Vlerësimit Profesional të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Raportuesi plotëson dokumentin e mendimit periodik, në bazë vjetore, për periudhën e komandimit, sipas formularit standard të miratuar nga Këshilli. Për këtë vlerësim zbatohen rregullat e parashikuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 10 të kësaj rregulloreje.

Neni 26 Të fundit

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI NR. 1 METODOLOGJIA E PIKËZIMIT ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË PROKURORIT TË KOMANDUAR NË KËSHILL

1. Metodologjia e pikëzimit ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për secilin kriter dhe treguesit përkatës ligjorë, mbi bazën e një sistemi pikësh të përcaktuar mbi meritat e prokurorit, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, duke respektuar parimin e pavarësisë së prokurorit.

2. Metodologjia e pikëzimit është pjesë përbërëse e “*Skemës së vlerësimit*”, sipas përcaktimeve të nenit 2 shkronja “II” të ligjit për statusin, i ndryshuar.

3. Me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit të komanduar në Këshill, pikëzimi bëhet, duke u bazuar në kriteret e posaçme të parashikuara në nenet 68-71, 73-78, 84-95 dhe 97, të ligjit për statusin.

4. Për aq sa ligji e lejon, përcaktimi i treguesve shtesë të çdo kriteri vlerësues dhe pesha specifike e tyre bëhet në tabelën e pikëzimit, pjesë e kësaj metodologjie.

5. Vlerësimi i prokurorit kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

6. Vlerësimi i prokurorit kryhet sipas këtyre niveleve:

a) vlerësimi i përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*” jepet në ato raste, kur prokurori është vlerësuar “*Shkëlqyeshëm*” për të katërta kriteret;

b) vlerësimi i përgjithshëm “*Shumë mirë*” jepet vetëm në ato raste, kur prokurori vlerësohet “*Shumë mirë*” për tri kriteret dhe “*Mirë*” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” duhet të jenë vlerësuar “*Shumë mirë*”;

c) vlerësimi i përgjithshëm “*Mirë*” jepet në rastin, kur aftësitë e prokurorit vlerësohen “*Mirë*” për dy kriteret dhe “*Mjaftueshëm*” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin, kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “*Mjaftueshëm*” dhe “*I pamjaftueshëm*”. Në çdo rast, kriteret “*aftësitë profesionale*” dhe “*etika dhe përkushtimi ndaj vlerave profesionale*” duhet të vlerësohen të paktën “*Mirë*”;

ç) vlerësimi i përgjithshëm “*I pamjaftueshëm*” jepet në rastet kur prokurori

- vlerësohet “*I pamjaftueshëm*” për të paktën në 3 kriteret; ose kur prokurori vlerësohet “*I pamjaftueshëm*” për kriteret “*aftësitë profesionale*” dhe “*etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale*”; dhe jo më shumë se “*Mirë*” për dy kriteret e tjera.

Për çdo kombinim tjetër të ndryshëm nga ato të parashikuar më lart, niveli i përgjithshëm i vlerësimit do të përcaktohet në varësi të mesatares së pikëve të katër kriterëve, sipas shkallës së pikëzimit të përcaktuar në pikën 9 të kësaj metodologjie. Në çdo rast, niveli i përgjithshëm i vlerësimit nuk mund të jetë më i lartë se niveli i vlerësimit për kriteret “aftësitë profesionale” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”.

7. Niveli i vlerësimit të prokurorit përcaktohet për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit.
8. Niveli i vlerësimit për çdonjërin nga kriteret e vlerësimit përcaktohet mbi bazën e një shkalle pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.
9. Shkalla e pikëzimit që përcakton nivelet e vlerësimit është:
- 90 deri 100 pikë “*Shkëlqyeshëm*”;
 - 70 deri 89 pikë “*Shumë mirë*”;
 - 50 deri në 69 pikë “*Mirë*”;
 - 30 deri në 49 pikë “*Mjaftueshëm*”; dhe
 - 1 deri në 29 pikë “*Pamjaftueshëm*”.
10. Brenda çdo kriteri vlerësimi bëhet ndarja e pikëve, sipas rëndësisë së çdo treguesi vlerësimi, duke shmangur përfundime që nuk janë përgjegjësi e prokurorit të komanduar në Këshill.
11. Në tabelën e pikëzimit përcaktohet ndarja e kriterëve të vlerësimit, lista e aspekteve të çdo kriteri, treguesit e vlerësimit dhe pikëzimi i tyre sipas nivelit, në funksion të pikëzimit dhe të vlerësimit final të prokurorit të komanduar në Këshill.
12. Kur gjatë periudhës së vlerësimit, prokurori e ka ushtruar funksionin (pjesërisht), i caktuar në një pozicion në prokurori dhe (pjesërisht) i komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, vlerësimi i tij etiko-profesional kryhet veçmas për secilin pozicion, sipas rregulloreve përkatëse të vlerësimit, të miratuara nga Këshilli.
13. Vlerësimi përfundimtar për periudhën e vlerësimit kryhet, duke mbledhur pikët e secilit vlerësim etik dhe profesional. Çdo vlerësim etiko-profesional shumëzohet me thyesën me **numërues** (numrin e viteve që është ushtruar funksioni në një pozicion) dhe **emërues** (vitet e periudhës së vlerësimit)¹.
14. Nëse prokurori ka ushtruar detyrën në pozicione të ndryshme brenda një viti kalendarik, aplikohen standardet matëse të vlerësimit, të lidhura me pozicionin ku prokurori ka ushtruar më gjatë detyrën.

1. AFTËSITË PROFESIONALE (100 pikë)

A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

a) Aftësitë hulumtuese për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë).

b) Aftësia për të interpretuar ligjin (25 pikë).

B. Arsytimi ligjor (50 pikë)

a) Qartësia, saktësia dhe kuptueshmëria e akteve (15 pikë).

b) Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve (10 pikë).

c) Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik (25 pikë).

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE (100 pikë)

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (50 pikë).

a) Aftësia për të realizuar volumin normal të punës (25 pikë).

b) Aftësia për të respektuar afatet (25 pikë).

B. Efektiviteti dhe metodologjia (25 pikë).

a) Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës (25 pikë).

C. Rregullshmëria dhe saktësia (25 pikë).

a) Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit (10 pikë).

b) Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit (15 pikë).

¹ Për shembull, në rast se gjatë periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, prokurori e ka ushtruar funksionin 2 vjet si i komanduar dhe 1 vit pranë një prokurorie të shkallës së parë, atëherë vlerësimi përfundimtar do të llogaritet: pikët sipas rregullores së vlerësimit të prokurorëve të komanduar(A) X (shumëzim) 2/3 + pikët e vlerësimit sipas rregullores së vlerësimit të prokurorëve në shkallën e parë (B) X 1/3. Në formë skematike formula do të ishte: A x 2/3+B x 1/3.

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

A. Etika në punë (35 pikë).

a) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

B. Integriteti (40 pikë).

a) Imuniteti ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, nderi dhe dinjiteti.

C. Paanësia (25 pikë).

a) Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

A. Aftësia e komunikimit (40 pikë)

a) Komunikimi i qartë dhe transparent (25 pikë).

b) Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë).

B. Aftësia për të bashkëpunuar (25 pikë)

a) Komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale (15 pikë).

b) Komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën e Këshillit (10 pikë).

C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

a) Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë).

b) Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë (10 pikë).

c) Publikimet ligjore akademike (5 pikë).

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË PROKURORIT (100 pikë).

Për të pikëzuar aftësinë e prokurorit të komanduar në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të dokumenteve të hartuara, vlerësuesi përqendrohet në mendimet vjetore të raportuesit dhe në relacionin periodik të prokurorit të komanduar.

Vlerësuesi çmon aftësitë hulumtuese, interpretuese dhe logjikën e prokurorit në lidhje me hartimin e dokumenteve ligjore, të tillë si: drafte aktesh nënligjore, projektvendime/vendime, opinione ligjore, analiza, materiale studimore krahasimore mbi kuadrin ligjor dhe jurisprudencial vendës dhe të huaj, projektraporte, raporte dhe materiale të tjera të lidhura me çështje specifike etj.

A. Njohuritë ligjore (50 pikë)

a) Aftësitë hulumtuese për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në mendimet vjetore të raportuesit, në relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- aftësia hulumtuese, e cila evidenton zotësinë e prokurorit të komanduar për të shqyrtuar në mënyrë tërësore burimet e shtypura dhe *online*, për të mbledhur informacione ligjore të sakta;

- aftësia e prokurorit të komanduar për të përcaktuar elementet faktuale të çështjes për trajtim dhe për të identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, sipas rastit;

- aftësia e prokurorit të komanduar për të përcaktuar elementet faktuale të çështjes për trajtim dhe për të identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, sipas rastit.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20

b) Aftësia për të interpretuar ligjin (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në mendimet vjetore të raportuesit, në relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit, në të cilat vlerësohet sipas rastit (pozicionit të prokurorit të komanduar dhe akteve përkatëse të përgatitura prej tij).

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- aftësia e prokurorit të komanduar për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjore dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit;
- për aq sa është e mundur, aftësia e prokurorit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

B. Arsyetimi ligjor (50 pikë)**a) Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria (15 pikë)**

Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësuesi bazohet në mendimet vjetore të raportuesit, në relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Ky tregues pikëzohet, referuar qartësisë, koncizitetit dhe lehtësisë në kuptueshmëri dhe lexueshmëri, të dokumenteve ligjore të hartuara/përpunuara nga prokurori i komanduar.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtëm:

- përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës;
- aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë;
- zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës;
- përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin;
- Përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

b) Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e dokumenteve ligjore (10 pikë)

Si burim vlerësimi për këtë tregues shërbejnë mendimet vjetore të raportuesit, në relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

- Vlerësimi i do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:
- Ndjekja e një metodologjie të caktuar, sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor, ligjor, apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit. Në matjen e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të dokumenteve ligjore nga raportuesi, për shkak të gabimeve materiale apo për mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo strukturën e rakorduar, sipas rastit.
- Struktura e qartë, e qëndrueshme dhe e mirorganizuar, e cila përmban:
- prezantimin e fakteve;
- identifikimin e dispozitave të zbatueshme të ligjit;
- dhe lidhjen e tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

c) Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përqendrohet në mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi i do të përqendrohet në elementet e mëposhtëm:

- aftësia e prokurorit të komanduar për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen konkrete për trajtim;
- cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore në dokumentet ligjore, të hartuara/përpunuara nga prokurori i komanduar. Në matjen e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të dokumenteve ligjore nga raportuesi, për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentimit, nëse burimet e vlerësimit përmbajnë të dhëna të tilla.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË PROKURORIT (100 pikë)

Megjithëse përgjegjësitë e prokurorit të komanduar mund të ndryshojnë sipas roleve specifike dhe komisioneve apo njësite, ku ata janë caktuar, prokurori i komanduar, në çdo detyrë, duhet të ketë aftësi të mira organizative në mënyrë që të jetë produktiv. Prokurori nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat, pjesë e punës në Këshill. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon se sa mirë prokurori i komanduar përdor kohën e tij/saj, si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë.

Prokurori i komanduar duhet të bëjë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës, në lidhje me detyrat dhe skadencat e përcaktuara në ligj, apo të vendosura si pjesë e punës në Këshill, pa krijuar pengesa në ecurinë e punës në komisione apo në Këshill.

A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (50 pikë)

a) Aftësia për të realizuar volumin normal të punës (25 pikë)

Si burim vlerësimi shërbejnë mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe formulari i vetëvlerësimit të prokurorit.

Ky tregues konsideron profilin sasior të punës së prokurorit të komanduar dhe vlerëson aftësinë tij për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera si pjesë e aktiviteteve të përgjithshme, si p.sh. pjesëmarrja në grupe pune, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave dhe çdo detyrë tjetër, sipas rastit.

Të dhënat në lidhje me këtë tregues duhet të analizohen sipas situatës, për të shmangur përfundime jo të favorshme të lidhura me aspekte që nuk janë përgjegjësi e prokurorit të komanduar. Përfundimet mbi të dhënat bazohen në kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e çështjeve, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

b) Aftësia për të respektuar afatet (25 pikë)

Për të pikëzuar këtë tregues, si burim vlerësimi shërbejnë mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe formulari i vetëvlerësimit të prokurorit.

Ky tregues konsideron profilin e shpejtësisë së punës së prokurorit të komanduar dhe vlerëson respektimin nga ana e tij të afateve të parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit apo të rakorduara me anëtarët e Këshillit, sipas rastit. Vlerësohet aftësia e prokurorit të komanduar për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet dhe detyrat që i janë caktuar për trajtim.

Të dhënat në lidhje me këtë tregues duhet të analizohen sipas situatës, për të shmangur përfundime jo të favorshme për çështje që nuk janë përgjegjësi e prokurorit të komanduar. Përfundimet mbi të dhënat bazohen në kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e çështjeve, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës.

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

B. Efektiviteti dhe metodologjia (25 pikë)

a) Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës (25 pikë)

Vlerësuesi përqendrohet në mendimet vjetore të raportuesit, në relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Aspekti i efektivitetit të punës së prokurorit të komanduar nënkupton aftësinë e tij për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën dhe burime të tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës.

Vlerësimi i do të përqendrohet në elementet e mëposhtme:

- realizimin efektiv dhe në kohë të veprimeve specifike procedurale dhe planit të punës;
- aftësia për të evidentuar çështjet për përshpejtimin e punës, ose ato me probleme procedurale;
- aftësia e prokurorit të komanduar për të qenë krijues dhe për të propozuar ide të reja për organizimin dhe menaxhimin efektiv të punës;

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

C. Rregullshmëria dhe saktësia (25 pikë)

a) Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit (10 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në mendimet vjetore të raportuesit, në relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Treguesi i rregullshmërisë vlerësohet dhe pikëzohet në bazë të renditjes së akteve dhe rregullshmërisë së dokumentacionit (fizik apo elektronik) që prokurori i komanduar u përcjell anëtarëve të Këshillit, apo aktet e dosjes së vlerësimit, sipas rastit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

b) Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit (15 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në mendimet vjetore të raportuesit, në relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit.

Treguesi i saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit vlerësohet dhe pikëzohet, duke mbajtur parasysh aftësinë e prokurorit të komanduar për të garantuar që dokumentacioni (fizik apo elektronik) që gjyqtari u përcjell anëtarëve të Këshillit apo aktet e dosjeve të vlerësimit, sipas rastit, të jenë të plota, ato të duhurat dhe t'i përkasin çështjes konkrete në trajtim.

Pikëzimi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Shkalla e aftësisë së prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6

Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE (100 pikë)

Pikëzimi i treguesve të këtij kriteri vlerësimi bëhet sipas një rendi zbritës, bazuar në parimin kushtetues që çdo prokuror, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Çdo prokuror e fillon procesin e vlerësimit me totalin e 100 pikëve, referuar këtij kriteri të vlerësimit. Gjatë procedurës së vlerësimit, pikët mund të zbriten në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues të dalë nga burimet e vlerësimit, krahasuar me ligjin, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes të miratuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë².

A. Etika në punë (35 pikë)

a) Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion (35 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, rezultatet e ankesave dhe verifikimin e tyre, si dhe formularin e integruar të vlerësimit të prokurorit.

Vlerësimi do të përqendrohet në elementet e mëposhtëm:

- aftësia e prokurorit për të pasur një sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme;
- aftësia për të shmangur çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe fyese, duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve që formalisht kualifikohen si në kundërshtim me ligjin.

Shkalla e etikës në punë e prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	7
Nën mesataren	14
Mesatare	21
Mbi mesataren	28
Shumë e lartë	35

B. Integriteti (40 pikë)

a) Imuniteti nga çdo ndikim apo presion i jashtëm, nderi dhe dinjiteti (40 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi përqendrohet në vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit, në rezultatet e ankesave dhe verifikimin e tyre, në mendimin e raportuesit dhe kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe në të dhënat e raporteve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. **Të dhënat e dala nga burimet e vlerësimit do të analizohen në mënyrë objektive, duke shmangur**

² Të cilat interpretohen, për aq sa është e mundur, në përputhje me:

i. Parimet e Bangalorit për sjelljen gjyqësore dhe komentari përkatës,

https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf;

ii. Opinionin nr. 9 (2014), datë 17 dhjetor 2014 të CCPE(Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, për Këshillin e Evropës) “Mbi normat dhe parimet evropiane në lidhje me prokurorët”;

iii. Opinionin nr. 13 (2018) i CCPE “Për pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe etikën e prokurorëve”;

iv. Udhëzimin e OKB-së i vitit 1990, “Mbi rolin e prokurorëve”;

v. Standardet për përgjegjësinë profesionale dhe deklaratat e detyrave dhe të drejtave themelore të prokurorëve, përcaktuara në vitin 1999 nga IAP (Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve); udhëzimin e Budapestit, “Mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë”, 2005; deklaratat e Bordosë mbi “Gjyqtarët dhe prokurorët në shoqërinë demokratike”, e vitit 2009

qëndrimin subjektiv të vlerësuesit apo anëtarit të Këshillit, të krijuar mbi bazën e njohjeve personale me prokurorin.

Vlerësimi do të bazohet në elementet e mëposhtëm:

- shmangia e lidhjeve të papërshtatshme ose shmangia e sjelljeve, që bëjnë të duket sikur ka lidhje të tilla të papërshtatshme;
- ushtrimi i detyrës me nder dhe dinjitet, në mënyrë që të përmbushë pritshmërinë e publikut;
- shmangia e çdo paragjykimi që mund të jetë i dëmshëm ose mund të konsiderohet si i dëmshëm për kryerjen e detyrave të caktuara;
- vetëdija e prokurorit se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut;
- përcjellja e vlerave personale dhe profesionale, duke shfaqur cilësitë personale, që e bëjnë të konsiderohet si shembull i mirë për të tjerët;
- shmangia e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për dinjitetin e individëve;
- keqpërdorimi i orarit të punës, personelit dhe burimeve të institucionit, për qëllime private;
- çdo sjellje apo veprimtari tjetër që cenon apo rrezikon të cenojë imazhin dhe figurën publike të prokurorit, të Këshillit dhe të sistemit të drejtësisë.

Parimet e *Bangalorit* konfirmojnë se nuk ka shkallë integriteti, të përkufizuara si të tilla. Integriteti është një karakteristikë që prokurori e ka ose nuk e ka. Integriteti është absolut. Në sistemin e drejtësisë, integriteti është më shumë se një virtyt, është një domosdoshmëri. Prandaj, në përputhje me rrethanat, në caktimin e pikëve në dispozicion sipas këtij treguesi, Këshilli mund të marrë në konsideratë dy mundësi, si më poshtë:

a) nëse ka informacione mjaftueshëm të besueshme se prokurorit i mungon integriteti, Këshilli do të caktojë minimumin e pikëve të mundshme.

b) nëse nuk ka informacione në dispozicion që tregojnë se prokurorit i mungon integriteti, konkluzioni duhet të jetë në favor të prokurorit dhe Këshilli do të caktojë maksimumin e pikëve të mundshme.

Shkalla e integritetit të prokurorit	Nr. i pikëve
E dobët	0
Shumë e lartë	40

C. Paanësia (25 pikë)

Në lidhje me këtë parim, paanësia e prokurorit të komanduar në Këshillin e Lartë të prokurorisë nënkupton mungesë paragjykimi në favor ose kundër prokurorëve, grupeve të veçanta, apo çështjeve për trajtim. Këshilli do të vlerësojë këtu imunitetin ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, aftësinë e prokurorit të komanduar për të shmangur një konflikt të mundshëm interesi që ndikon ose mund të krijojë dyshime për paanësinë e tij, si dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave. Prokurori duhet të jetë i drejtë dhe të duket si i tillë. Paraqitja dhe cilësia e drejtësisë janë thelbësore.

a) Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (25 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë kriter, shërbejnë masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit (nëse ka), rezultatet e ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, formulari i vetëvlerësimit të prokurorit, si dhe mendimi i kryetarit të Këshillit.

Prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të shmangin përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykime. Qëndrimet personale nuk duhet të ndërhyjnë në vendimmarrjen e prokurorit të komanduar në KLP.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- respektimi i grupeve të cenueshme, i barazisë gjinore dhe i të drejtave të pakicave;
- shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese;
- shmangia e çdo tendence për paragjykim;
- shmangia e ndërhyrjes së mendimeve personale në vendimmarrjen e prokurorit.

Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)

Ky kriter vlerëson kapacitetin personal dhe angazhimin profesional të prokurorit që detajohet në treguesit e mëposhtëm.

A. Aftësia e komunikimit (40 pikë)

a) Komunikimi i qartë dhe transparent (25 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, formulari i vetëvlerësimit të prokurorit, si dhe mendimi i kryetarit të Këshillit.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive dhe transparente;
- aftësia për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të saktë me kolegët, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Qartësia dhe transparencia e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	5
Nën mesataren	10
Mesatare	15
Mbi mesataren	20
Shumë e lartë	25

b) Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, formulari i vetëvlerësimit të prokurorit, si dhe mendimi i kryetarit të Këshillit.

Prokurori duhet të tregojë kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit. Pikëzimi i këtij treguesi bëhet sipas një rendi zbritës, duke prezumuar që prokurori i gëzon cilësi të tilla. Çdo prokuror e fillon pikëzimin me 15 pikë, të cilat zbriten sipas tabelës së mëposhtme, në varësi të treguesve që dalin nga burimet e vlerësimit.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- respektimi i dispozitave ligjore për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

- respektimi i udhëzimeve dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për aq sa gjejnë zbatim;

Respektimi i konfidencialitetit	Nr. i pikëve
I dobët	3
Mesatar	9
I lartë	15

B. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët (25 pikë)

a) Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale (15 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, formulari i vetëvlerësimit të prokurorit, si dhe mendimi i kryetarit të Këshillit.

Prokurori duhet të ketë aftësinë dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me kolegët, pa cenuar pavarësinë e tij në vendimarrje.

Vlerësimi i këtij treguesi do të bazohet në elementet e mëposhtme:

- angazhimi në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njëse, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale dhe në çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë e Këshillit;

- gatishmëria për të ndarë me kolegët përvojën e përfutur në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Shkalla e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	3
Nën mesataren	6
Mesatare	9
Mbi mesataren	12
Shumë e lartë	15

b) Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën (10 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, formulari i vetëvlerësimit të prokurorit, si dhe mendimi i Kryetarit të Këshillit.

Prokurorët e komanduar në Këshill ndërveprojnë rregullisht me personelin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese me personelin e Këshillit krijon një ambient pune harmonik dhe produktiv. Këshilli do të vlerësojë nëse nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi shfaqjen e mungesës së respektit ndaj punonjësve të administratës së prokurorisë, keqtrajtimin progresiv dhe sistematik të tyre, nëpërmjet përdorimit të fjalorit të papërshtatshëm, thashethemeve, përjashtimit social etj.

Shkalla e komunikimit	Nr. i pikëve
E dobët	2
Nën mesataren	4
Mesatare	6
Mbi mesataren	8
Shumë e lartë	10

C. Gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)

a) Pjesëmarrja e prokurorit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale (20 pikë)

Një nga objektivat e vlerësimit të veprimtarisë profesionale është edhe identifikimi i nevojave për trajnim, duke i dhënë mundësi prokurorit t'i kushtojë kohë vetë-përmirësimit në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjit, jurisprudencës dhe doktrinës. Me qëllim ngritjen e tyre profesionale, prokurorët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Prokurori duhet t'i kushtojë kohë zhvillimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnime që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnime në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet, duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e prokurorit në trajnime. Pjesëmarrja e prokurorit në trajnime të tjera vlerësohet, bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.

Pikëzimi i këtij treguesi bëhet referuar numrit të trajnimeve, kohëzgjatjes tërësore të tyre në raport me një temë të caktuar. Këshilli konsideron vlerë të shtuar për ngritjen profesionale trajnimet afatgjata, përfshirë edhe trajnimet afatshkurtra të specializuara në një fushë të caktuar, të organizuara në periudha kohore të ndërprera.

Pjesëmarrja e prokurorit Periudha 3-vjeçare	Nr. i pikëve
15-120 ditë:	20
Më pak se 15 ditë ose më shumë 120 ditë:	4

Pjesëmarrja e prokurorit Periudha 5-vjeçare	Nr. i pikëve
30-200 ditë:	20
Më pak se 30 ditë ose më shumë 120 ditë:	4

b) Pjesëmarrja e prokurorit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun (5 pikë)

Si burime vlerësimi lidhur me këtë tregues, shërbejnë mendimet vjetore të raportuesit, relacionet periodike të prokurorit të komanduar, formulari i vetëvlerësimit të prokurorit, mendimi i kryetarit të Këshillit, si dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të prokurorit të komanduar.

Prokurori mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin e drejtësisë në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalimet publike; prezantimet në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde, me qëllim rritjen e efikasitetit; kontributet në hartimin e legjislacionit; aktivitetet mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe e ndryshme të interesit, me qëllim rritjen e cilësisë së sistemit të prokurorisë; ndërgjegjësimi i publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla nuk është gjithmonë në varësi të vullnetit të prokurorit të komanduar, të gjithë prokurorët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Një ose dy pikë të tjera u shtohen në vlerësim prokurorëve që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë hetimore, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së prokurorit, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burimet e vlerësimit të këtij treguesi.

c) Publikimet ligjore akademike (5 pikë)

Si burim vlerësimi shërbejnë dosja personale e prokurorit të komanduar, relacionet periodike të prokurorit të komanduar dhe çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të tij, të cilat japin të dhëna për sasinë, tipologjinë dhe impaktin e punimeve dhe publikimeve ligjore akademike.

Me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për prokurorin, publikimet ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinės. Nga 1 deri në 5 pikë caktohen për publikimet ligjore akademike, ku përfshihen artikuj, kapituj, monografi ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

BURIMET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i prokurorëve bazohet në këto burime:

- a) dosja personale e prokurorit të komanduar në Këshill;
- b) mendimet vjetore të raportuesit,
- c) relacionet periodike të prokurorit të komanduar,
- ç) formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit të komanduar;
- d) mendimi i kryetarit të Këshillit;
- dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj prokurorit gjatë periudhës së vlerësimit;
- e) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj prokurorit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
- ë) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese;
- f) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e prokurorit në veprimtaritë trajnuese;
- g) kundërshtimet e prokurorit të komanduar në Këshill dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
- gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të prokurorit.

ANEKSI nr. 2

RELACION PERIODIK I PROKURORIT TË KOMANDUAR

Për periudhën DD/MM/VVVV - DD/MM/VVVV

TË DHËNAT E PROKURORIT

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Adresa e-mail zyrtar:

Adresa e-mail privat:

Numër telefoni:

Funksioni:

Relacioni vjetor i prokurorit të komanduar dhe hapat për plotësimin e tij

1. Ky relacion plotësohet nga prokurori në zbatim të nenit 10 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

2. Relacioni përbën burim vlerësimi, në kuptim të nenit 8 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

3. Relacioni paraqet një përmbledhje faktike të detyrave dhe aktiviteteve të tjera të prokurorit të komanduar, gjatë vitit kalendarik paraardhës.

4. Prokurori përpilon relacionin në rubrikat përkatëse. Relacioni depozitohet në zyrën e Protokollit brenda muajit janar të çdo viti kalendarik.

5. Për vlerësimin e parë etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshill, ky relacion plotësohet nga prokurori, në zbatim të nenit 25 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

1. PËRSHKRIMI I ROLIT

Në këtë rubrikë prokurori i komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë përshkruan shkurtimisht rolin/et e mbuluara gjatë periudhës së relacionit, duke specifikuar periudhat përkatëse, nëse ka mbuluar formalisht ose konkretisht më shumë se një rol. **(Deri në 150 fjalë.)**

2. DETYRAT E KRYERA SIPAS ROLIT

Në këtë rubrikë prokurori përshkruan dhe liston në mënyrë skematike detyrat e kryera sipas rolit, duke përfshirë për aq sa është e mundur, sipas rastit, të dhëna statistikore mbi çështje/dosje të caktuara dhe të përfunduara/mbyllura. Nëse është e mundur, prokurori grupon detyrat dhe aktivitetet e kryera sipas llojit (p.sh. raporte analitike; drafte aktesh nënligjore, relacione tematike etj.) dhe specifikon periudhat përkatëse, për aq sa është e mundur. Rekomandohet përdorimi i formatit tabelor ose me pika.

3. DETYRA TË TJERA TË PËRGJITHSHME

Në këtë rubrikë prokurori përshkruan dhe liston në mënyrë skematike detyrat të tjera të përgjithshme, të kryera gjatë periudhës së relacionit, si p.sh. pjesëmarrja në grupe pune, detyra *ad hoc* etj., që evidentojnë shkallën dhe disponibilitetin për të bashkëpunuar me kolegët dhe për të ndarë përvojën e përfutur. Rekomandohet përdorimi i formatit tabelor ose me pika.

4. TRAJNIME

Në këtë rubrikë prokurori duhet të përcaktojë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, të zhvilluara brenda dhe jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke specifikuar përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin.

5. AKTIVITETE TË TJERA TË RËNDËSISHME

Në këtë rubrikë prokurori duhet të evidentojë për aq sa është e mundur, sipas rastit, pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari ndër-institucionale jashtë funksionit, me ose pa pagesë, duke listuar aktivitete të tilla si: fjalimet publike; prezantimet në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; kontributet në hartimin e legjislacionit; aktivitetet mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm, me qëllim rritjen e cilësisë së prokurorisë dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

6. ASPEKTE QË KANË NDIKUAR NË ECURINË E PUNËS

Në këtë rubrikë prokurori duhet të listojë, sipas rastit, nëse ka pasur ngjarje, faktorë apo situata objektive që kanë ndikuar në punën e tij, si p.sh. leje të lidhura me shëndetin, leje lindje, situata emergjence, katastrofa natyrore etj., duke specifikuar, për aq sa është mundur, kohëzgjatjen.

Hartuar nga: Emër: Mbiemër: Data dhe nënshkrimi

Për periudhën 20__ - 20__

RAPORTUESI	TË DHËNAT E PROKURORIT <i>Emri:</i> <i>Mbiemri:</i> <i>Datëlindja:</i> <i>Vendbanimi:</i> <i>Adresa e e-mailit zyrtar:</i> <i>Adresa e e-mailit privat:</i> <i>Numër telefoni:</i> <i>Gjykata:</i> <i>Funksioni:</i>
------------	--

Mendimi i raportuesit dhe hapat për plotësimin e tij.

1. Mendimi i raportuesit plotësohet sipas përkufizimit dhe në zbatim të nenit 10, të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

2. Mendimi i raportuesit i hartuar me frekuencë vjetore përbën burim vlerësimi, në kuptim të nenit 8 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”. Mendimi i raportuesit përmban një vlerësim të punës së prokurorit të komanduar, gjatë vitit kalendarik paraardhës.

3. Raportuesi harton mendimin mbi prokurorin bazuar në relacionin periodik të prokurorit sipas nenit 10 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”, dhe në eksperiencën e punës dhe bashkëpunimit të përditshëm me të.

4. Raportuesi, brenda muajit shkurt të çdo viti, plotëson dokumentin e mendimit vjetor periodik për prokurorin e komanduar dhe e protokollon në sekretari, duke i përcjellë një kopje edhe prokurorit të komanduar.

5. Brenda tri ditëve nga njoftimi i plotësimit të ‘Mendimit të raportuesit’, prokurori mund të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar, duke paraqitur kërkesë për zhvillimin e një takimi me Raportuesin.

6. Pas realizimit të dëgjësës me prokurorin, Raportuesi jep mendimin përfundimtar në lidhje me veprimtarinë e prokurorit, duke plotësuar rubrikën e këtij formulari të emërtuar “Mendimi përfundimtar”.

7. Për vlerësimin e parë etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshill, raportuesi plotëson dokumentin e mendimit periodik, në bazë vjetore, për periudhën e komandimit, në zbatim të nenit 25 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”. Raportues për këtë periudhë konsiderohet Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

MENDIMI PËRKUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

1. Aftësitë profesionale

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të prokurorit, raportuesi shpreh mendimin mbi aftësinë e prokurorit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, në lidhje me hartimin e dokumenteve ligjore, të tillë si: drafte aktesh nënligjore, projektvendime/vendime, opinione ligjore, analiza, materiale studimore krahasimore mbi kuadrin ligjor dhe jurisprudencial vendës dhe të huaj, projektraporte, raporte dhe materiale të tjera të lidhura me çështje specifike etj.

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Në këtë rubrikë raportuesi jep mendimin mbi aftësitë hulumtuese të prokurorit, të cilat evidentojnë zotësinë për të shqyrtuar në mënyrë tërësore burimet e shtypura dhe *online*, dhe për të mbledhur informacione ligjore të sakta. Këtu përfshihet gjithashtu analiza mbi aftësinë e prokurorit të komanduar, për të përcaktuar elementet e faktit të çështjes për trajtim dhe për të identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, sipas rastit.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin).				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin

Në këtë rubrikë raportuesi jep mendimin mbi aftësinë e prokurorit të komanduar, për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimin e tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimin dhe/ose analizimin e të dhënave, në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Mendimi përfshin edhe analizën mbi aftësinë e prokurorit të komanduar për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjore dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit. Për aq sa është e mundur, raportuesi shpreh mendimin edhe mbi aftësinë e prokurorit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria

Në këtë rubrikë raportuesi jep mendimin mbi qartësinë, koncizitetin dhe lehtësinë në kuptueshmëri dhe lexueshmëri, të dokumenteve ligjore të hartuara/përpunuara nga prokurori i komanduar. Raportuesi bazohet në aspekte të tilla, si: përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe e strukturës së fjalisë, për të shprehur kuptimin; përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e dokumenteve ligjore

Në këtë rubrikë raportuesi shpreh mendimin, nëse dokumentet ligjore të hartuara/përpunuara nga prokurori i komanduar përmbajnë një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirorganizuar, së cilës prokurori i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit.

Në veçanti, raportuesi i referohet ndjekjes së një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit. Në formulimin e mendimit, raportuesi konsideron edhe shpeshësinë e kthimit të dokumenteve ligjore, për shkak të gabimeve materiale apo për mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo strukturën e rakorduar, sipas rastit.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik

Raportuesi shpreh mendimin mbi cilësinë e analizës në dokumentet ligjore, të përpunuar/hartuar/komentuar nga prokurori, sipas rastit, mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e prokurorit të komanduar, për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen konkrete për trajtim. Në formulimin e mendimit, raportuesi konsideron edhe shpeshtësinë e kthimit të dokumenteve ligjore, për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentimit, nëse e konsideron të rëndësishme.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

2. Aftësitë organizative

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale, raportuesi shpreh mendimin mbi aftësinë e prokurorit të komanduar, për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat, pjesë e punës në Këshill. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë prokurori i komanduar përdor kohën e tij/saj, si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë. Prokurori i komanduar duhet të bëjë përpjekje maksimale në menaxhimin efektiv të kohës në lidhje me detyrat dhe afatet e përcaktuara në ligj, apo të vendosura si pjesë e punës në Këshill, pa krijuar pengesa në ecurinë e punës në komisione apo në Këshill.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës

2.A.a Aftësia për të realizuar volumn normal të punës
Në këtë rubrikë raportuesi konsideron profilin sasior të punës së prokurorit të komanduar dhe shpreh mendimin mbi aftësinë e prokurorit për të realizuar volumn normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera si pjesë e aktiviteteve të përgjithshme, si p.sh. pjesëmarrja në grupe pune, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave, dhe çdo detyrë tjetër, sipas rastit. Në formulimin e mendimit raportuesi analizon tërësisht situatën, për të shmangur përfundime jo të favorshme të lidhura me aspekte që nuk janë përgjegjësi e prokurorit të komanduar, si p.sh. kompleksiteti i çështjeve për trajtim, volumni i çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

2.A.b Aftësia për të respektuar afatet

Në formulimin e mendimit për këtë tregues, raportuesi konsideron profilin e shpejtësisë së punës së prokurorit të komanduar dhe analizon respektimin nga ana e tij të afateve orientuese, të parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit apo të rakorduara me anëtarët e Këshillit, sipas rastit. Raportuesi shpreh mendimin mbi aftësinë e prokurorit të komanduar për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet dhe detyrat që i janë caktuar për trajtim, duke vlerësuar tërësisht situatën, për të shmangur përfundime jo të favorshme të lidhura me aspekte që nuk janë përgjegjësi e prokurorit të komanduar, si p.sh. kompleksiteti i çështjeve për trajtim, volumi i çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin).				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

2.B Efektiviteti dhe metodologjia

2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës

Në këtë rubrikë raportuesi shpreh mendimin mbi efektivitetin e punës së prokurorit të komanduar. Raportuesi analizon aftësinë e prokurorit të komanduar për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën dhe burime të tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës. Raportuesi merr parasysh aftësinë për të evidentuar çështjet për përshpejtimin e punës, ose ato me probleme procedurale, si edhe aftësinë e prokurorit për të qenë krijues dhe për të propozuar ide të reja për organizimin dhe menaxhimin efektiv të punës.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin).				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

2.C Rregullshmëria dhe saktësia

2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit

Në këtë rubrikë raportuesi shpreh mendimin mbi renditjen e akteve dhe rregullshmërinë e dokumentacionit (fizik apo elektronik) që prokurori i komanduar u përcjell anëtarëve të Këshillit, apo

aktet e dosjes së vlerësimit, sipas rastit. Dokumentacioni i përcjellë duhet të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit

Në formulimin e mendimit mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit, raportuesi merr parasysh aftësinë e prokurorit të komanduar, për të garantuar që dokumentacioni (fizik apo elektronik) që prokurori u përcjell anëtarëve të Këshillit, apo aktet e dosjeve të vlerësimit, sipas rastit, të jenë të plota, ato të duhurat dhe t'i përkasin çështjes konkrete në trajtim.

<i>Si e vlerëson Raportuesi shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i Raportuesit (Këtu, Raportuesi jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

Raportuesi (organi kolegjal apo individual)

Emër: Mbiemër: Nënshkrimi:

Emër: Mbiemër: Nënshkrimi:

Emër: Mbiemër: Nënshkrimi:

Marrë njoftim nga prokurori, më datë _____

Emër: Mbiemër: Nënshkrimi:

ANEKSI 4

MENDIMI I KRYETARIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Për periudhën 20__ - 20__

TË DHËNAT E PROKURORIT

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Adresa e-mail zyrtar:

Adresa e-mail privat:

Numër telefoni:

Prokuroria:

Funksioni:

Mendimi i kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe hapat për plotësimin e tij:

1. Mendimi i kryetarit të Këshillit plotësohet sipas përkufizimit dhe në zbatim të nenit 10, të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

2. Mendimi i kryetarit të Këshillit, i hartuar për periudhën e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit të komanduar, është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi, në kuptim të nenit 8 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

3. Ky formular standard i mendimit të kryetarit të Këshillit ndjek strukturën e aspekteve dhe treguesve të kriterit të vlerësimit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” të parashikuara në ligjin “Për statusin”, të adaptuara e të detajuara për prokurorët e komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, sipas aneksit nr. 1 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

4. Për çdo tregues, sipas metodologjisë në aneksin 1 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”, kryetari i Këshillit përcakton nivelin e vlerësimit të prokurorit të komanduar në KLP, bazuar në relacionin periodik të prokurorit, eksperiencën e punës dhe bashkëpunimit me të, si dhe në burimet në dispozicion.

5. Kryetari i Këshillit plotëson mendimin e tij, sipas rubrikave përkatëse të këtij formulari standard, dhe ia njofton atë prokurorit, jo më vonë se katër javë nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional.

6. Brenda tri ditëve nga njoftimi i mendimit, prokurori mund të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me kryetarin e Këshillit.

7. Pas realizimit të dëgjësës me prokurorin, kryetari jep mendimin përfundimtar në lidhje me veprimtarinë e prokurorit, duke plotësuar rubrikën e këtij formulari të emërtuar “Mendimi përfundimtar”.

8. Kryetari i Këshillit duhet të shpjegojë dhe argumentojë mendimin e tij, veçanërisht për ato kritere, për të cilat mendimi i tij përfundimtar ndryshon nga vetëvlerësimi i kryer nga prokurori.

MENDIMI PËRKUNDREJT KRITERIT

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Ky kriter bazohet në parimin kushtetues që çdo prokuror, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Për këtë kriter, vlen parimi i prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të pasur një sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe fyese, duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve që formalisht kualifikohen si në kundërshtim me ligjin.

<i>Si e vlerëson kryetari i Këshillit shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit të Këshillit (Këtu, kryetari i Këshillit jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

3.B Integriteti

3.B.a. Imuniteti nga çdo ndikim apo presion i jashtëm, nderi dhe dinjiteti

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për: shmangien e lidhjeve të papërshtatshme ose sjelljeve që bëjnë të duket sikur ka lidhje të tilla të papërshtatshme; për të ushtruar detyrën me nder dhe dinjitet, në mënyrë që të përmbushë pritshmërinë e publikut; për shmangien e çdo paragjykimi që mund të jetë i dëmshëm ose mund të konsiderohet si i dëmshëm për kryerjen e detyrave të caktuara; për të pasur vetëdijen se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut; për të përcjellë vlera personale dhe profesionale, duke shfaqur cilësitë personale, që e bëjnë të konsiderohet si shembull i mirë për të tjerët; për të shmangur sjellje që tregojnë mungesë respekti për dinjitetin e individëve; për të mos keqpërdorur orarin e punës, personelit dhe burimeve të institucionit për qëllime private; si dhe për të shmangur çdo sjellje apo veprimtari tjetër, që cenon apo rrezikon të cenojë imazhin dhe figurën publike të prokurorit, të Këshillit dhe të sistemit të drejtësisë.

<i>Si e vlerëson kryetari i Këshillit shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>	
E dobët ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?	
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)	
Jo ☐	
Mendimi përfundimtar i kryetarit të Këshillit (Këtu, kryetari i Këshillit jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)	

E dobët ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--

3.C Paanësia e prokurorit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Me këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykim, respektimin e grupeve të cënueshme, të barazisë gjinore dhe të drejtave të pakicave, shmangien e ndërhyrjes së mendimeve personale në vendimmarrjen e prokurorit.

<i>Si e vlerëson kryetari i Këshillit shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit të Këshillit (Këtu, kryetari i Këshillit jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

1. Vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimit profesional

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i prokurorit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe personelin administrativ të prokurorisë, gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të saktë me kolegët, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

<i>Si e vlerëson kryetari i Këshillit shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit të Këshillit (Këtu, kryetari i Këshillit jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për respektimin e dispozitave ligjore për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale; respektimin e udhëzimeve dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për aq sa gjejnë zbatim.

<i>Si e vlerëson kryetari i Këshillit shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>		
E dobët ☐	Mesatare ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?		
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato)		
Jo ☐		
Mendimi përfundimtar i kryetarit të Këshillit (Këtu, kryetari i Këshillit jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)		
E dobët ☐	Mesatare ☐	Shumë e lartë ☐

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me kolegët dhe shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të bashkëpunuar me kolegët, pa cenuar pavarësinë e tij në vendimmarrje; angazhimi në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njësuere, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale, dhe në çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë e Këshillit; si dhe gatishmëria për të ndarë me kolegët, përvojën e përfutur në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

<i>Si e vlerëson kryetari i Këshillit shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit të Këshillit (Këtu, kryetari i Këshillit jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën e Këshillit

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të ndërvepruar rregullisht me personelin e Këshillit, nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese, me qëllim krijimin e një ambienti pune harmonik dhe produktiv.

<i>Si e vlerëson kryetari i Këshillit shkallën e aftësisë së prokurorit?</i>				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Ka pasur kundërshtime të prokurorit?				
Po ☐ (nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato).				
Jo ☐				
Mendimi përfundimtar i kryetarit të Këshillit (Këtu, kryetari i Këshillit jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)				
E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐

4.C Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.b Pjesëmarrja në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë

Me këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari për të përmirësuar sistemin e drejtësisë, veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe e ndryshme të interesit, me qëllim rritjen e cilësisë së sistemit të prokurorisë dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Si e vlerëson kryetari i Këshillit shkallën e aftësisë së prokurorit? (Kryetari i Këshillit jep mendim paraprak për këtë tregues në rastet kur ai është në dijeni të angazhimit të prokurorit, apo kur ky angazhim ka qenë i iniciuar nga vetë kryetari i Këshillit.)

Ka pasur kundërshtime të prokurorit?

Po ☐ (Nëse po, duhet të pasqyrohen se cilat kanë qenë ato.)

Jo ☐

Mendimi përfundimtar i kryetarit të Këshillit (Këtu, kryetari i Këshillit jep mendimin përfundimtar dhe përcakton shkallën e aftësisë, pas realizimit të dëgjësës me prokurorin.)

Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Emër: Mbiemër: Nënshkrimi:

Marrë njoftim nga prokurori, më datë _____

Emër: Mbiemër: Nënshkrimi:

ANEKSI nr. 5

FORMULARI I VETËVLERËSIMIT TË PROKURORIT TË KOMANDUAR

Për periudhën 20__ - 20__

TË DHËNAT E PROKURORIT
<i>Emri:</i>
<i>Mbiemri:</i>
<i>Datëlindja:</i>
<i>Vendbanimi:</i>
<i>Adresa e-mail zyrtar:</i>

<i>Adresa e-mail privat:</i>
<i>Numër telefoni:</i>
<i>Prokuroria:</i>
<i>Funksioni:</i>

Formulari i vetëvlerësimit dhe hapat për plotësimin e tij

1. Formulari i vetëvlerësimit plotësohet nga prokurori i komanduar, në zbatim të nenit 86, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (ligji për statusin), dhe të nenit 10 të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

2. Formulari i vetëvlerësimit është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të nenit 77, shkronjat “ç” dhe “d”, të ligjit për statusin dhe të nenit 8, të rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

3. Prokurori plotëson formularin e vlerësimit, sipas rubrikave përkatëse, e nënshkruan atë dhe ia dorëzon relatorit brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit mbi fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional.

4. Prokurori vetëvlerësohet sipas katër grup-kritereve të vlerësimit, të parashikuara në ligjin “Për Statusin”, duke përzgjedhur në mënyrë të pavarur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë, për çdo tregues vlerësimi. Prokurori plotëson formularin e vetëvlerësimit, duke marrë parasysh relacionet e tij periodike dhe mendimet vjetore të raportuesit.

5. Në pjesën dedikuar kriterit të vlerësimit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, prokurori ka të drejtë të japë shpjegime dhe të argumentojë vetëvlerësimin e tij, duke parashtruar të dhënat, kushtet faktike dhe arsyet që, sipas tij/saj, justifikojnë një shkallë më të lartë aftësie se ajo që rezulton nga të dhënat statistikore.

VLERËSIMI PËRKUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

1. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË PROKURORIT.

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të prokurorit, vlerësohet aftësia e prokurorit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

1. A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Në këtë tregues vlerësohen aftësitë hulumtuese, të cilat evidentojnë zotësinë e prokurorit të komanduar për të shqyrtuar në mënyrë tërësore burimet e shtypura dhe *online*, për të mbledhur informacione ligjore të sakta. Vlerësohet gjithashtu aftësia e prokurorit të komanduar për të përcaktuar elementet e faktit të çështjes për trajtim, dhe për të identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, sipas rastit.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu prokurori duhet të japë shpjegime, referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit.)

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin

Në këtë tregues vlerësohet, sipas rastit (pozicionit të prokurorit të komanduar dhe akteve përkatëse të përgatitura prej tij): aftësia për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim, apo pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Vlerësohet gjithashtu aftësia e prokurorit të komanduar, për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjore dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit. Brenda këtij treguesi vlerësohet gjithashtu, për aq sa është e mundur, aftësia e prokurorit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu prokurori duhet të japë shpjegime, referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit.)

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria

Në këtë tregues vlerësohen aspekte të tilla, si: përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës; aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë; zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës; përzgjedhja e kujdesshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin; përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente të termave teknikë.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu prokurori duhet të japë shpjegime, referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit.)

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e dokumenteve ligjore

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të mbajtur një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirë organizuar në dokumentet ligjore të hartuara/përpunuara prej tij, strukturë, të cilës prokurori i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit.

Në veçanti, vlerësohet ndjekja e një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit. Në matjen e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të dokumenteve ligjore nga raportuesi, për shkak të gabimeve materiale apo për mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo strukturën e rakorduar, sipas rastit.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu prokurori duhet të japë shpjegime, referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit.)

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik

Në këtë tregues vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore në dokumentet ligjore të hartuara/përpunuara nga prokurori. Argumentimi logjik nënkupton aftësinë e prokurorit të komanduar për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen konkrete për trajtim. Në matjen e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të dokumenteve nga raportuesi për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentimit, nëse burimet e vlerësimit përmbajnë të dhëna të tilla.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu prokurori duhet të japë shpjegime, referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit.)

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e prokurorit për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të organizuar, administruar dhe kontrolluar efektivisht

procedurat si pjesë e punës në Këshill, aftësia e menaxhimit efektiv të kohës si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës

2.A.a Aftësia për të realizuar volumin normal të punës

Në këtë tregues vlerësohet profili sasior i punës së prokurorit të komanduar dhe aftësia e tij për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera si pjesë e aktiviteteve të përgjithshme, si p.sh. pjesëmarrja në grupe pune, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave dhe çdo detyrë tjetër, sipas rastit.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu prokurori duhet të japë shpjegime, referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit, dhe situatës faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, për të shmangur përfundime jo të favorshme të lidhura me aspekte që nuk janë përgjegjësi e prokurorit.)

2.A.b Aftësia për të respektuar afatet

Ky tregues konsideron profilin e shpejtësisë së punës së prokurorit dhe vlerëson respektimin nga ana e tij të afateve të parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit apo të rakorduar me anëtarët e Këshillit, sipas rastit. Vlerësohet aftësia e prokurorit të komanduar për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor, çështjet dhe detyrat që i janë caktuar për trajtim.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu prokurori duhet të japë shpjegime, referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe situatës faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, për të shmangur përfundime jo të favorshme të lidhura me aspekte që nuk janë përgjegjësi e prokurorit.)

2.B Efektiviteti dhe metodologjia

2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të menaxhuar në mënyre efektive kohën dhe burime të tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës. Vlerësohet aftësia për të evidentuar çështjet për përsheptimin e punës ose ato me probleme procedurale. Vlerësohet gjithashtu aftësia e prokurorit të komanduar për të qenë krijues dhe për të propozuar ide të reja për organizimin dhe menaxhimin efektiv të punës.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime (Këtu prokurori duhet të japë shpjegime referuar, veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit).

2.C Rregullshmëria dhe saktësia

2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit

Treguesi i rregullshmërisë vlerësohet në bazë të renditjes së akteve dhe rregullsisë së dokumentacionit (fizik apo elektronik) që prokurori i komanduar u përcjell anëtarëve të Këshillit, apo aktet e dosjes së vlerësimit, sipas rastit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit

Treguesi i saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit vlerësohet dhe pikëzohet, duke mbajtur parasysh aftësinë e prokurorit për të garantuar që dokumentacioni (fizik apo elektronik) që prokurori u përcjell anëtarëve të Këshillit, apo aktet e dosjeve të vlerësimit, sipas rastit, të jenë të plota, ato të duhurat dhe t'i përkasin çështjes konkrete në trajtim.

Si e vlerëson prokurori shkallën e aftësisë së tij?

	Nën mesataren		Mbi mesataren	
E dobët ☐	☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo prokuror, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë.

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në çfarëdo funksioni, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe fyese, duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin.

Si e vlerëson prokurori shkallën e tij të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion?

			Mbi mesataren	
E dobët ☐	Nën mesatare ☐	Mesatare ☐	☐	Shumë e lartë ☐

Shpjegime:

3.B Integriteti

3.B.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit: për të shmangur lidhjet e papërshtatshme ose shmangien e sjelljeve që bëjnë të duket sikur ka lidhje të tilla të papërshtatshme; për të ushtruar detyrën me nder dhe dinjitet në mënyrë që të përmbushë pritshmërinë e publikut; për shmangien e çdo paragjykimi që mund të jetë i dëmshëm ose mund të konsiderohet si i dëmshëm për kryerjen e detyrave të caktuara; për të pasur vetëdijen se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut; për të përcjellë vlera personale dhe profesionale, duke shfaqur cilësitë personale, që i bëjnë të konsiderohen si shembuj të mirë për të tjerët; për të shmangur sjellje që tregojnë mungesë respekti për dinjitetin e individëve; për të mos keqpërdorur orarin e punës, personelit dhe burimeve të institucionit për qëllime private; si dhe për të shmangur çdo sjellje apo veprimtari tjetër, që cenon apo rrezikon të cenojë imazhin dhe figurën publike të prokurorit, të Këshillit dhe të sistemit të drejtësisë.

Si e vlerëson prokurori aftësinë e tij për shmangien e sjelljeve të pahijshme, nderin dhe dinjitetin e tij?

(Prezumohet se prokurori ka shkallë shumë të lartë integriteti)

E dobët ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	--

Shpjegime:

3.C Paanësia e prokurorit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Me këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për: të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, si dhe çdo tendencë për paragjykim; respektimin e grupeve të cënueshme, të barazisë gjinore dhe të drejtave të pakicave; shmangien e ndërhyrjes së mendimeve personale në vendimmarrjen e prokurorit.

Si e vlerëson prokurori aftësinë e tij për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shume e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

Shpjegime

4. VLERËSIMI I AFTËSIVE PERSONALE DHE ANGAZHIMIT PROFESIONAL

Me anë të këtij kriteri vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i prokurorit, duke vlerësuar aftësitë komunikuese, aftësinë për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Këshillit dhe gatishmërinë e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të saktë me kolegët, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.

Si e vlerëson prokurori aftësinë e tij për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shume e lartë ☐
----------------------------------	--	-----------------------------------	--	--

Shpjegime

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të treguar kujdesin maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit.

Si e vlerëson prokurori aftësinë e tij në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale?

E dobët ☐	Mesatare ☐	Shumë e lartë ☐
----------------------------------	-----------------------------------	--

Shpjegime:

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët dhe shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të bashkëpunuar me kolegët, pa cenuar pavarësinë e tij në vendimmarrje; angazhimi në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve njëse, hartimin e modeleve të unifikuara të akteve procedurale dhe në çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë e Këshillit; si dhe gatishmëria për të ndarë me kolegët përvojën e përfutur në aktivitetet e ndryshme trajnuese.

Si e vlerëson prokurori aftësinë e tij në lidhje me shkallën e komunikimit, bashkëpunimin me kolegët dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Shpjegime:				

4.B.b. Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën e Këshillit.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e prokurorit për të ndërvepruar rregullisht me personelin e Këshillit, nxitja e marrëdhënieve bashkëpunuese, me qëllim krijimin e një ambienti pune harmonik dhe produktiv.

Si e vlerëson prokurori aftësinë e tij në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën e Këshillit?

E dobët ☐	Nën mesataren ☐	Mesatare ☐	Mbi mesataren ☐	Shumë e lartë ☐
Shpjegime:				

4.C Gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e prokurorit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Me këtë tregues vlerësohet angazhimi i prokurorit në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe në aktivitete të tjera trajnuese jashtë këtij programi, me qëllim ngritjen profesionale të prokurorit.

A e ka përmbushur prokurori detyrimin ligjor mbi pjesëmarrjen në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, gjatë periudhës së vlerësimit?

Po ☐	Jo ☐
Shpjegime: (Këtu prokurori duhet të përcaktojë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, të zhvilluar jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke specifikuar përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.)	

4.C.b Pjesëmarrja e prokurorit në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë

Me këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari për të përmirësuar sistemin e drejtësisë, veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e cilësisë së sistemit të prokurorisë dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Shpjegime (Prokurori duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari ndërinstytucionale, si më sipër. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.)

4.C.c Publikime ligjore akademike

Me anë të këtij treguesi vlerësohet angazhimi i prokurorit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinės, të tilla si: artikuj, kapituj, monografi, ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

Shpjegime (*Prokurori duhet të listojë këtu informacione mbi publikimet ligjore akademike të tij gjatë periudhës së vlerësimit. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.*)

Për t'u plotësuar nga prokurori

Plotësuar nga:

Emër: Mbiemër: Nënshkrimi:

Dorëzuar në sekretari më datë:

Marrë në dorëzim nga kryetari i Këshillit më datë:

Emër: Mbiemër: Nënshkrimi:

ANEKSI NR. 6

PROJEKTRAPORT I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË PROKURORIT TË KOMANDUAR

MODEL

Tiranë, më _____.20____

Përgatiti: _____

NDARJA³ A

TË DHËNAT E PROKURORIT

Në këtë rubrikë plotësohen të dhënat personale të prokurorit, të dhënat për rolin dhe funksionin pranë Këshillit dhe periudhën e vlerësimit.

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Vjetërsia në detyrë:

Adresa e-mail zyrtar:

Adresa e-mail privat:

Numër telefoni:

Prokuroria:

³ Ndarjet dhe emërtimet e tyre me germa pasqyrohen në këtë raport model, për të orientuar pjesët e veçanta të aktit.

Funksioni:

Vlerësimi i mëparshëm:

Masa disiplinore:

Periudha e vlerësimit:

NDARJA B

RAPORTUESI DHE RELATORI

Raportues: (për periudhën _____)

Raportues: (për periudhën _____)

Raportues: (për periudhën _____)

Vlerësues/relator:

NDARJA C

QËLLIMI

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit, i përgatitur nga relatori i caktuar me short, ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së prokurorit në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale të tij. Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim, mbi të cilin përcaktohet niveli i vlerësimit për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit, si dhe ai i përgjithshëm, të cilët i propozohen për miratim Mbledhjes Plenare.

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit hartohet, bazuar në parashikimet e neneve 53, paragrafi 10, 68 e vijues, 89 e vijues dhe 93, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e prokurorëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji për statusin), dhe Rregulloren për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, dhe anekset përkatëse.

Me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së prokurorit për çdo tregues, aspekt dhe kriter vlerësimi, relatori bën analizë të integruar të të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit.

NDARJA Ç

BURIMET E VLERËSIMIT

Në këtë rubrikë listohen burimet e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 77, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin”, dhe rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”, të individualizuara për prokurorin, për të cilin hartohet projektraporti.

1. Burimi 1
2. Burimi 2
3. Burimi 3
4.

NDARJA D

PROCEDURA

Në këtë rubrikë përshkruhet, në rend kronologjik, procedura e ndjekur nga momenti i fillimit të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit, deri në momentin e hartimit të projektraportit të vlerësimit.

NDARJA E

PASQYRIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

Në këtë rubrikë listohen burimet e vlerësimit, pasqyrohen dhe analizohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet shkalla e aftësisë/nivelit të veprimtarisë së prokurorit për çdo tregues vlerësimi, dhe bëhet pikëzimi dhe propozimi për nivelin e vlerësimit të prokurorit, për secilin nga katër kriteret e vlerësimit.

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË PROKURORIT TË KOMANDUAR

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e prokurorit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së prokurorit, bazuar në mendimet vjetore të raportuesit, në relacionet periodike të prokurorit të komanduar, si dhe në formularin e vetëvlerësimit të prokurorit. Aftësia profesionale e prokurorit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësitë hulumtuese për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e prokurorit, në lidhje me: - zotësinë për të shqyrtuar në mënyrë tërësore burimet e shtypura dhe <i>online</i> , për të mbledhur informacione ligjore të sakta; - përcaktimin e fakteve të çështjes për trajtim; - identifikimin e natyrës së çështjes; - përcaktimin e ligjit të zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, sipas rastit.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e prokurorit, në lidhje me:

- aftësinë për të interpretuar ligjin e identifikuar;
- arsyetimin e prokurorit për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet konkrete për trajtim;
- pasqyrimin dhe/ose analizimin e të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes për trajtim, në përpunimin e akteve dhe dokumenteve ligjore, dhe/ose në arsyetimet me shkrim ose verbale, sipas rastit;
- analizën e jurisprudencës, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar, në mbështetje të një interpretimi të caktuar.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

1.B Arsyetimi ligjor**1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria****Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:

Referuar burimit 1, rezulton se

Referuar burimit 2, rezulton se

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e prokurorit, në lidhje me:

- përdorimin e thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të gjuhës shqipe;
- shprehjen e mendimit qartë dhe me sa më pak fjalë;
- zbatimin e saktë të rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës;
- përzgjedhjen e kujdesshme të gjuhës dhe përdorimin e të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç); organizimin e paragrafëve dhe të strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin;
- përdorimin në mënyrë korrekte dhe konsistente të termave teknikë.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e dokumenteve ligjore**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:

Referuar burimit 1, rezulton se

Referuar burimit 2, rezulton se

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e prokurorit, në lidhje me:

- strukturën e qartë, të qëndrueshme, të mirorganizuar të dokumenteve ligjore të hartuara/përpunuara nga prokurori, së cilës prokurori i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit;

- ndjekjen e një metodologjie të caktuar sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor, apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit.

- Në matjen e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të dokumenteve ligjore nga raportuesi, për shkak të gabimeve materiale apo për mospërputhje me metodologjinë e unifikuar dhe/apo strukturën e rakorduar, sipas rastit.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik**Burimet e vlerësimit:**

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:

Referuar burimit 1, rezulton se

Referuar burimit 2, rezulton se

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e prokurorit në drejtim të cilësisë së analizës, mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore, në lidhje me:

- identifikimin e marrëdhënieve shkak-pasojë;
- analizën e lidhjes midis koncepteve, instituteve dhe dispozitave, si dhe zbatimin e tyre në lidhje me çështjen konkrete për trajtim.

Në vlerësimin e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshtësia e kthimit të dokumenteve ligjore nga Raportuesi, për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentimit, nëse burimet e vlerësimit përmbajnë të dhëna të tilla.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

Propozim për nivelin e vlerësimit

KRITERI 1

AFTËSITË PROFESIONALE TË PROKURORIT

Pikët

Niveli i vlerësimit

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e prokurorit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat, pjesë e punës në Këshill. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon se sa mirë prokurori përdor kohën e tij si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës

2.A.a a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohet profili sasior i punës së prokurorit dhe aftësitë e tij për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera si pjesë e aktiviteteve të përgjithshme, si p.sh. pjesëmarrja në grupe pune, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave dhe çdo detyrë tjetër, sipas rastit. Analiza e integruar e të dhënave dhe vlerësimi për këtë tregues bazohet në kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e çështjeve, si dhe të aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, për të shmangur përfundime jo të favorshme, të lidhura me aspekte që nuk janë përgjegjësi e prokurorit.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

2.A.b b. Aftësia për të respektuar afatet

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohet profili i shpejtësisë së punës së prokurorit dhe aftësitë e tij në lidhje me: - respektimin e afateve të parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit apo të rakorduara me anëtarët e Këshillit, sipas rastit; - zgjidhjen dhe përfundimin në afatin e duhur kohor të çështjeve dhe detyrave që i janë caktuar për trajtim. - analiza e integruar e të dhënave dhe vlerësimi për këtë tregues bazohet në kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e çështjeve, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës,

për të shmangur përfundime jo të favorshme të lidhura me aspekte që nuk janë përgjegjësi e prokurorit.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

2.B Efektiviteti dhe metodologjia

2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës

Burimet e vlerësimit:

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:

Referuar burimit 1, rezulton se

Referuar burimit 2, rezulton se

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e prokurorit në lidhje me:

- menaxhimin në mënyrë efektive të kohës dhe burimeve të tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës;
- evidentimin e çështjeve për përshpejtimin e punës, ose ato me probleme procedurale;
- qasjen proaktive dhe propozimin e ideve të reja për organizimin dhe menaxhimin efektiv të punës, zgjidhjen dhe përfundimin në afatin e duhur kohor të çështjeve dhe detyrave që i janë caktuar për trajtim.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

2.C Rregullshmëria dhe saktësia

2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit

Burimet e vlerësimit:

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:

Referuar burimit 1, rezulton se

Referuar burimit 2, rezulton se

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e prokurorit në lidhje me renditjen e akteve dhe rregullshmërinë e dokumentacionit (fizik apo elektronik) që prokurori i komanduar u përcjell anëtarëve të Këshillit, apo aktet e dosjes së vlerësimit, sipas rastit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe vlerësohen aftësitë e prokurorit për të garantuar që dokumentacioni (fizik apo elektronik) që prokurori u përcjell anëtarëve të Këshillit, apo aktet e dosjeve të vlerësimit, sipas rastit, të jenë të plota, ato të duhurat dhe t'i përkasin çështjes konkrete në trajtim.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

Propozim për nivelin e vlerësimit KRITERI 2 AFTËSITË ORGANIZATIVE TË PROKURORIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet, duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo prokuror, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo prokuror e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur, sipas rastit, pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, me qëllim vlerësimin e angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion të prokurorit, sjelljen e kujdesshme, objektive, me vetëpërmbajtje dhe maturi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

3.B Integriteti i prokurorit

3.B.a Imuniteti nga çdo ndikim apo presion i jashtëm, nderi dhe dinjiteti

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për këtë tregues, për shkak të parimit të prezumimit, në rast se nuk ka të dhëna për cenimin e integritetit të prokurorit, shkalla e integritetit prezumohet të jetë shumë e lartë. Në rast se nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna të mjaftueshme dhe të besueshme që mund të cenojnë integritetin e prokurorit, shkalla e integritetit vlerësohet me 0 pikë.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

3.C Paanësia e prokurorit

Paanësia e prokurorit nënkupton mungesë paragjykimi në favor

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në drejtim të shmangies së përdorimit të gjuhës diskriminuese, tendencës për paragjykim dhe ndikimit të qëndrimeve personale në vendimmarrjen e prokurorit.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

Propozim për nivelin e vlerësimit

KRITERI 3

ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Pikët	Niveli i vlerësimit
-------	---------------------

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i prokurorit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në drejtim të komunikimit efektiv dhe transparent dhe aftësisë për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për këtë tregues, për shkak të parimit të prezumimit, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen ato të dhëna që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, të tilla që mund të çojnë në cenimin e konfidencialitetit dhe të dhënave personale, për të cilat prokurori vihet në dijeni për shkak të funksionit.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës profesionale

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në drejtim të aftësisë dhe disponibilitetit të prokurorit për

të bashkëpunuar me kolegët, pa cenuar pavarësinë e tij në ushtrimin e detyrës, angazhimin në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike, përmirësimet e legjislacionit, diskutimi rreth zbatimit të vendimeve njëse, hartimi i modeleve të unifikuara të akteve procedurale etj.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën e Këshillit

Burimet e vlerësimit:

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:

Referuar burimit 1, rezulton se

Referuar burimit 2, rezulton se

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen, në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të prokurorit me administratën e Këshillit.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori përcakton shkallën e aftësisë së prokurorit dhe pikët e propozuara për këtë tregues.)

4.C Gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja e prokurorit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Burimet e vlerësimit:

1. Burimi 1;
2. Burimi 2;
3.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit:

Referuar burimit 1, rezulton se

Referuar burimit 2, rezulton se

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me angazhimin e prokurorit në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës apo në aktivitete të tjera trajnuese, jashtë këtij programi, që synojnë ngritjen e tij profesionale.

Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi

(Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori propozon pikëzimin mbi bazën e shkollës së angazhimit që tregon prokurori, në drejtim të ngritjes së tij profesionale, nëpërmjet trajnimeve.)

4.C.b Pjesëmarrja e prokurorit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë

Burimet e vlerësimit:

1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në drejtim të gatishmërisë së prokurorit për pjesëmarrje në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori propozon pikëzimin jo vetëm mbi bazën e angazhimit të prokurorit në veprimtaritë e mësipërme, por edhe të sasisë dhe cilësisë së kontributit të dhënë prej tij.)

4.C.c Publikimet ligjore akademike

Burimet e vlerësimit: 1. Burimi 1; 2. Burimi 2; 3.
Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit: Referuar burimit 1, rezulton se Referuar burimit 2, rezulton se
Analiza e të dhënave Për të vlerësuar këtë tregues, analizohen në mënyrë të integruar dhe vlerësohen të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me angazhimin e prokurorit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinės, të tilla si: artikuj, kapituj, monografi ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).
Shkalla e aftësisë së prokurorit dhe pikëzimi (Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, relatori propozon pikëzimin mbi bazën e shkallës së kontributit të dhënë nga prokurori për zhvillimin e doktrinės.)

Propozim për nivelin e vlerësimit KRITERI 4 AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit

NDARJA F

PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMIN DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e prokurorëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer prej tij, propozon nivelin e vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit, si dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të prokurorit.

Propozim për nivelin e vlerësimit për çdo kriter

Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të prokurorit		
2. Aftësitë organizative të prokurorit		
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale		
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional		

Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit

NDARJA G

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e prokurorëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, bën propozim për trajnime dhe/ose rekomandon hapa, të cilët i vlerëson të nevojshëm për t’u ndërmarrë nga prokurori, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së tij.

RELATOR

(EMRI, MBIEMRI DHE NËNSHKRIMI)

ANEKSI 7			
		PIKËT PËR PROKURORIN	VLERËSIMI
	1. AFTËSITË PROFESIONALE	0	
A. Njohuritë ligjore (50 pikë)	a. Aftësitë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm (25 pikë)		
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin (25 pikë)		
B. Arsytimi ligjor (50 pikë)	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria (15 pikë)		
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar (10 pikë)		
	c. Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik (25 pikë)		
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (50 pikë)	2. AFTËSITË ORGANIZATIVE	0	
	a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës (25 pikë)		
	b. Aftësia për të respektuar afatet (25 pikë)		
B. Efektiviteti dhe metodologjia (25 pikë)	a. Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës (25 pikë)		
C. Rregullsia dhe saktësia (25 pikë)	a. Rregullsia e mbajtjes së dokumentacionit (10 pikë)		
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit (15 pikë)		
	3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	0	
A. Etika në punë (35 pikë)	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion (35 pikë)		
B. Integriteti (40 pikë)	a. Imuniteti ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, nderi dhe dinjiteti (40 pikë)		
C. Paanësia (25 pikë)	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese (25 pikë)		
	4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL (100 pikë)	0	
A. Aftësia e komunikimit (40 pikë)	a. Komunikimi i qartë dhe transparent (25 pikë)		
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (15 pikë)		
B. Aftësia për të bashkëpunuar (25 pikë)	a. Komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale (15 pikë)		
	b. Komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën e Këshillit (10 pikë)		
C. Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera (35 pikë)	a. Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magistraturës (20 pikë)		
	b. Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë (10 pikë)		
	c. Publikimet ligjore akademike (5 pikë)		

ANEKSI NR. 8

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE TË PËRPILUARA NGA PROKURORI I KOMANDUAR SIPAS POZICIONIT/ROLIT, PËR VITIN _____

Nr.	Dokumenti ligjor	Objekti	Data e marrjes në dorëzim	Afati i verifikimit	Krahasuar me afatin ligjor, nënligjor ose të rakorduar	Kthimi i dokumentit ligjor	Shkaku ⁴

⁴ Shkaqe të kthimit sipas metodologjisë janë tri : a) kthimi i dokumentit ligjor për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentit; b) kthimi i dokumentit ligjor për shkak të gabimeve materiale ose mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo rakorduar; dhe c) kthimi i dosjes për shkak të parregullsisë të dokumentacionit.

--	--	--	--	--	--	--	--

TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE TË PËRPILUARA NGA PROKURORI I KOMANDUAR GJATË KRYERJES SË DETYRAVE TË TJERA TË PËRGJITHSHME (JASHTË POZICIONIT/ROLIT), PËR VITIN _____

Nr.	Dokumenti ligjor	Objekti	Data e marrjes në dorëzim	Afati i verifikimit	Krahasuar me afatin ligjor, nënligjor ose të rakorduar	Kthimi i dokumentit ligjor	Shkaku⁵

⁵ Shkaqe të kthimit sipas metodologjisë janë tri : a) kthimi i dokumentit ligjor për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentit; b) kthimi i dokumentit ligjor për shkak të gabimeve materiale ose mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo rakorduar; dhe c) kthimi i dosjes për shkak të parregullsisë të dokumentacionit.